

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, Gjyqtari Naim Mehulli, në çështjen juridike kontestimore të paditësve **F.U, A.U.1, R.U, A.U.2.** dhe **A.U.3.** të gjithë nga ..., të cilët i përfaqëson me autorizim avokati Z.I nga ..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ me seli në ..., të cilën e përfaqëson me autorizim avokati A.K nga Prishtina, lidhur me kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 38,000.00 euro, pas përfundimit të seancës kryesore, me datën **23/04/2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET Pjesërishtë e Bazuar kërkesëpadia e paditësve **F.U, A.U.1, R.U, A.U.2.** dhe **A.U.3** dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve me seli në sipas përgjegjësisë së ndarë në shkallën prej **80%**, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit nga auto-përgjegjësia, t’iu paguaj shumat e specifikuar si me poshtë:

a) Paditëses F.U:

- ✓ Për dhimbje shpirtërore të përjetuar për shkak të vdekjes së personit të afërm-bashkëshortit shumë prej **6000 euro**, me kamat ligjore sikur parat të jenë të depozituara në bankat e Kosovës, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 23/04/2018 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit ndërsa **REFUZOHET E PA BAZUAR** pjesa e kërkesëpadisë së paditëses F.U, për dëmin mbi shumë e gjykuar dhe atë: për dhimbje shpirtërore të përjetuar për shkak të vdekjes së personit të afërm- bashkëshortit shumë prej 1200 euro.

b) Paditësit A.U.1:

- ✓ Për dhimbje shpirtërore të përjetuar për shkak të vdekjes së personit të afërm-babait shumë prej **6000 euro**, me kamat ligjore sikur parat të jenë të depozituara në bankat e Kosovës, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 23/04/2018 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit ndërsa **REFUZOHET E PA BAZUAR** pjesa e kërkesëpadisë së paditësit A.U.1, për dëmin mbi shumë e gjykuar dhe atë: Për dhimbje shpirtërore të përjetuar për shkak të vdekjes së personit të afërm- babait shumë prej 1200 euro.

c) Paditësit R.U:

- ✓ Për dhimbje shpirtërore të përjetuar për shkak të vdekjes së personit të afërm-babait shumë prej **6000 euro**, me kamat ligjore sikur parat të jenë të depozituara në bankat e Kosovës, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 23/04/2018 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit ndërsa **REFUZOHET E PA BAZUAR** pjesa e kërkesëpadisë së paditësit R.U, për dëmin mbi shumë e gjykuar dhe atë: Për dhimbje shpirtërore të përjetuar për shkak të vdekjes së personit të afërm- babait shumë prej 1200 euro.

ç) Paditësit A.U.2 :

- ✓ Për dhimbje shpirtërore të përjetuar për shkak të vdekjes së personit të afërm-babait shumë prej **6000 euro**, me kamat ligjore sikur parat të jenë të depozituara në bankat e Kosovës, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 23/04/2018 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit ndërsa **REFUZOHET E PA BAZUAR** pjesa e kërkesëpadisë së paditësit A.U, për dëmin mbi shumë e gjykuar dhe atë: Për dhimbje shpirtërore të përjetuar për shkak të vdekjes së personit të afërm- babait shumë prej 1200 euro.

d) Paditësit A.U.3:

- ✓ Për dhimbje shpirtërore të përjetuar për shkak të vdekjes së personit të afërm-babait shumë prej **6000 euro**, me kamat ligjore sikur parat të jenë të depozituara në bankat e Kosovës, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 23/04/2018 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit ndërsa **REFUZOHET E PA BAZUAR** pjesa e kërkesëpadisë së paditësit A.U.3, për dëmin mbi shumë e gjykuar dhe atë: Për dhimbje shpirtërore të përjetuar për shkak të vdekjes së personit të afërm- babait shumë prej 1200 euro.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “....”, që paditësve, t’ua paguaj shumat e gjykuara në piken I a), b), c), ç) dhe d) të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe demin material për shpenzimet e varrimit dhe ngritjes se përmendore në shumë prej **1500 euro** si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,930.40 euro, në afatin prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. REFUZOHET pjesa e kërkesë padis së paditësve sa i përket demit material për shpenzimet e varrimit dhe ngritjes se përmendores në shumë prej 500 euro si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësit në padi dhe kërkesëpadinë e precizuar përmes të autorizuarit të tyre në shqyrtimin e mbajtur në këtë gjykatë, kanë kërkuara që kërkesëpadinë e tyre të

miratoj në tërësi si të bazuar për format dhe në shumën e precizuar si në parashtrësën e dorzuar ne gjykate ne seancën e datës 03/04/2018, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësve t'ia kompensoj demin material dhe jo material që e kanë pësuar paditësit si pasoj e aksidentin të komunikacionit të datës 08/12/2014 ka vdekur bashkëshorti i paditëses e parë dhe babai i te paditësve tjer K.U.

I autorizuari i paditësve ka kërkuar nga gjykata qe ne kuadër te përgjegjësisë se ndarë 80 % për te paditurën dhe 20% për te ndjerin, shumat si vijon atë: Për paditësen F.U-bashkëshorten e te ndjerit K.U në emër dhimbjeve shpirtërore t'ua paguaj shumën prej 7200 euro, ndërsa për paditësit A.U.1, Remzi Ujkani, A.U.2 dhe A.U.3 fëmijët e tani te ndjerit K.U, në emër të dhimbjeve shpirtërore ka kërkuar që të paguaj shumën secilit nga 7200 euro apo shumen e tërësishme për fëmijët e te ndjerit ne vler prej 28800 euro, pastaj në emër shpenzimet e varrimit të paguaj shumën prej 1200 euro dhe për ngritjen e përmendores të paguaj shumën prej 800 euro, e po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës civile si vijon: në emër të përpilimit të padis shumën prej 208 euro, për dy seanca shumën prej 1,622.40 euro, për taks gjyqësore për padi 100 te gjitha me kamat vjetore prej 8% duke filluar nga data e gjykimit e deri ne pagesën përfundimtare.

Përfaqësuesja e të paditurës së Kompanisë së Sigurimeve “.....” A.K në seancën gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare në mes tjerash ka deklaruar: Mbetem në tërësi si ne deklarimet ne seancat e kaluara ashtu qe bazën juridike te kërkesëpadiisë ne kuptim te përgjegjësisë për shkaktimin e aksidentit e kundërshtoj pjesërisht me arsyetimin se edhe këmbësori tani i ndjere ka kontribuar ne shkaktimin e aksidentit duke trupuar rrugën ne vendin i cili nuk është i dedikuar për këmbësorë, fakt i cili vërtetohet edhe me ekspertizën e komunikacionit te punuar ne procedure penale sipas te cilës përgjegjësia primare ne shkaktimin e aksidentit bie ndaj te siguruarës te te paditurës, ndërsa përgjegjësin sekondare i atribuohet këmbësorit tani te ndjerit, ashtu qe e paditura pranon 70% te përgjegjësisë te te siguruarit te saj, po ashtu e paditura pjesërisht konteston lartësinë e kërkesëpadiisë lidhur me dhimbjet shpirtërore për vdekjen e te afërmit, paditësit me ane te prcizmimit te kërkesëpadiisë i kane propozuar Gjykatës qe te aprovoje shumen prej 9200 euro për secilin paditës për dhimbjet shpirtërore duke ja zbritur 20% për shkak te përgjegjësisë, dhe atë shumen prej 7200 euro, ashtu qe e paditura e kundërshton lartësinë e kërkesëpadiisë për këtë forme te demit duke konsideruar se është tejet e larte ne kundërshtim me praktikat gjyqësore dhe rregulloren e Bankës Qendrore. Sa i përket demit material e paditura e kundërshton kërkesëpadiinë lidhur me ngritjen e përmendores me arsyetimin se nuk ka prova materiale se këto shpenzime janë kryer. E paditura po ashtu kundërshton edhe kamatën vjetore ne lartësi prej 8% duke pas parasysh faktin se e paditura edhe ne procedure te rregullt i është përgjigjur kërkesës per kompensim demi, andaj e paditura i propozon Gjykatës qe ne rastin konkret te aprovohet kamata te cilinë praktikojnë bankat e Kosove për mjetet e depozituara mbi 1 vit pa destinim te caktuar. Sa i përket kërkesës te shpenzimeve e procedurës i propozoj Gjykatës qe te vendose për lartësinë e tyre sipas suksesit ne procedure.

Gjykata, për vërtetimin e drejtë dhe të plot të gjendjes faktike në procedurën e provave me pëlqimin e palëve i ka lexuar: Lexohet Raporti i Aksidentit 2014-BR-609 I DT. 08.12.2014, bashke me raportin e oficerit, kallximi penal i dt 08.12.2014, se bashku me skicën e vendit të aksidentit, Raporti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri i dt.08.12.2014, Raporti i Qendrës Klinike Universitare-Qendra emergjente i dt.08.12.2014, Udhëzimi për Konsultim, Vërtetimi mjekësor për vdekje, Raporti i mjekut për vdekje i dt. 08.12.2014, Certifikata e vdekjes për të ndjerin K.U e datës se lëshimit 03.02.2015, Deklarata e Bashkësisë Familjare e datës se lëshimit 03.02.2015, Certifikatë e lindjes për F.U e dt. se lëshimit 03.02.2015, Certifikatë e lindjes për A.U.1. e datës se lëshimit 04.02.2015, Certifikatë lindjes për R.U e datës se lëshimit 03.02.2015, Certifikatë e lindjes për A.U.2. e datës se lëshimit 03.02.2015, Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, p.nr 125/2015 e dt. 01.10.2015, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PA1.nr.1328/2015 e dt. 07.12.2015, Ekspertiza e fatkeqësisë së komunikacionit e dt. 19.12.2014, Certifikatë e lindjes së A.U.3 e dt. se lëshimit 23.02.2018.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se në këtë aksident e ka humbur jetën K.U dhe kjo vërtetohet me vërtetimin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, me numër të protokollit e datës 20/07/2015 si dhe nga Certifikata e vdekjes me numër rendor e datës 03/02/2015 e po ashtu kjo vërtetohet edhe me Aktgjykimi penal P.nr.125/2015 datës 01.10.2015, po ashtu për gjykatën nuk është kontestuese fakti se paditësja F.U ka qene bashkëshortja e tani të ndjerit K.U ndërsa paditësit e tjerë janë fëmijët e të njëjtit kjo vërtetohet me Deklaratën për bashkuesin familjare me numër rendor e datës si dhe certifikata e lindjes së paditëses, e po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se shkaktari kryesor i aksidentit ka qenë i siguruar tek e paditura dhe ka mbajtur polisen e sigurimit me numër dhe ka pasur sigurim deri me datën 7/06/2015, kjo vërtetohet me raportin e aksidentit nr.2014-BR-609 e datës. 08/12/2014.

Me provat e administruara Gjykata ka gjetur se me datën 08/12/2014, rreth orës 17:00, ka ardhur deri të aksidenti i komunikacionit kur ngasësi i automjetit VW 1XHO ishte duke lëvizur në rrugën magjistrale dhe me të arritur përball lokalit “..... në duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushtet e rrugës (natë) nga pakujdesia me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet këmbësorin K.U. i cili në atë moment ishte duke kaluar rrugën nga ana e majte në të djathtë në drejtim të lëvizjes së automjetit dhe si pasojë e kësaj goditje këmbësori përplasët në parafango dhe rrezohet në tokë ku nga lëndimet ndërron jete në QKUK në Prishtinë.

Nga mendimet dhe konstatimet përfundimtare të ekspertëve të komunikacionit ing.F.T, vërtetohet se shkaktari kryesor i aksidentit është shoferi i veturës VW 1XHO A.M i cili e ka drejtuar veturën në pa ju përshtatur shpejtësinë e lëvizjes

dhe kushteve te rrugës, ndërsa këmbësori tani i ndjeri K.U i kanë dhënë kontribut te natyrës sekondare këtij aksidenti.

Gjykata vlerësoj se provat që vërtetojnë këtë gjendje faktike, janë në lidhmëni njëra me tjetrën dhe logjike në mes vete ndërsa në anën tjetër nuk kishte ndonjë propozim për nxirjen e ndonjë ekspertize tjetër të komunikacionit dhe për këtë arsye ia fali besimin e plot këtyre ekspertizes të komunikacionit, ngase ishte mjaft bindëse për gjykatën.

Gjykata, lidhur me këtë rast erdhi në përfundim se e paditura mbanë përgjegjësi të ndarë në shkaktimin e dëmit në shkallen prej 80%, ashtu siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që shkaktari i aksidentit me lëshime primare ka qenë ngasësi i automjetit të markës “VW 1XHO”, i cili ka qenë i siguruar tek e paditura dhe e ka drejtuar automjetit me shpejtësi me të madhe se që është e lejuar, duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të krijuar në rrugën me dukshmëri të zvogëluar, kurse i tani i ndjeri mban përgjegjësi në shkaktimin e dëmit në shkallën prej 20 %, sepse i njëjti me rastin e aksidentit ka kaluar rrugën nga ana e majtë ne te djathtë edhe pse gjat kalimit te rrugës ka qen i obliguar qe te këtë kujdes te posaçëm dhe gjithherë te shfrytëztoj vendkalimin e këmbësoreve ku ekzistojnë.

Gjykata duke u bazuar në deklaratën për bashkuesin familjare e datës 03/02/2015 si dhe nga certifikatat e lindjes qe gjenden ne shkresat e lendes, ka vërtetuar se paditësit janë anëtar te ngushtë te familjes (bashkëshortja dhe fëmijët) me tani të ndjerin K.U, në kuptim të dispozites se nenit 184 al.1 dhe 2 te LMD, ua ka pranuar kompensimin e demit jo material si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Me rastin e aprovimit të pjesërishëm të kërkesë padis për këtë lloj të demit, gjykata ka marr parasysh rrethanat që kanë mundur dhe që kanë ndikuar në intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve shpirtërore që kanë përjetuar paditësit, për shkak të humbjes së burrit-babait të tyre.

Me këtë rast gjykata ka pasur parasysh sidomos raportin e paditësve me tani të ndjerin duke marr për bazë rrethanën se raportet në mes bashkëshorteve respektivisht prindërve me fëmijëve janë shumë emocionale dhe shpirtërore, në këtë kuptim gjykata vlerëson se dhimbjet shpirtërore të paditësve për shkak të vdekjes së burrit-babit të tyre kanë qenë shumë të larta, prandaj aprovimi i kërkesë padis pjesërisht nga ana e gjykatës është në pajtim me të mirën e shkelur dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimit.

Nisur nga kjo që u tha dhe duke pasur parasysh rëndësinë e të mirave të cenuara dhe qëllimin e shpërblimit në të holla, kjo gjykatë konsideron se paditësit, me ndihmën e shumave të caktuara, do të mund të përjetonin një satisfakcion të konsiderueshëm për dhimbjet shpirtërore të shkaktuara me vdekjen burrit, respektivisht babit të tyre. Dhimbjet e paditësve janë të pamatshme dhe nuk mund të hiqen me kurrfarë shpërblimi në të holla. Megjithatë, shpërblimi i dëmit në të holla, mund të zbut dhimbjen shpirtërore dhe duke i kënaqur disa nevoja të caktuara jetësore që ndihmojnë në vendosjen e baraspeshës shpirtërore dhe emocionale të paditësve. Shpërblimi në të holla i dëmit jo material nuk është qëllim, por mjet me të cilën të dëmtuarit, duke i

kënaqur nevojat që nuk do të mund t'i plotësonin, iu bënë më lehtë jetën e tyre duke bërë atë më të durueshme.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, shumat e caktuara përfaqësojnë një satisfakcion moral, me të cilin ua zbutë dhimbjet e pësuar shpirtërore paditësve për humbjen e anëtarit të ngushtë të familjes si dhe gjatë vendimmarrjes gjykata e ka pasur parasysh edhe praktiken gjyqësore, ndërsa pjesën tjetër të kërkesë padis për këtë lloj të demit mbi shumën e gjykuar e refuzoj si të pa bazuar, për shkak se ishte e lartë dhe nuk ishte në harmoni me praktiken e deritanishme gjyqësore të Gjykatave në Kosovë.

Për demin e gjykuar material sa i përket shpenzimeve të varrimit dhe ngritjes së perkujtimeve, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitës së nenit 177 të LMD-së. Me këtë rast mbi bazën e përgjegjësisë se ndarë të të paditurës dhe duke pasur parasysh shpenzimet e varrimit dhe ceremonive të nevojshme fetare sipas adeteve dhe zakoneve të vendit prej nga vjen familja e të ndjerit, tani paditësit, gjykata ka caktuar shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për pjesën refuzuese të kërkesë padis që ndërlidhet me demin material, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që nga ana e palës paditëse gjykatës nuk iu ofrua prova me të cilin vërtetohet dëmi. Paditësit nuk kanë prezantuar asnjë provë me të cilin kishte me u vërtetua lartësia e kërkesë padis së pretenduar për demin material, që i referohet shpenzimeve të varrimit dhe ngritjes së përmendores. Andaj në mungesë të dëshmive për demin material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit për pjesën e refuzuar.

Gjykata, vlerëson se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të demit për paditësit paraqesin shpërblim real dhe të drejt që paditësit me këto mjete ti plotësojnë nevojat dhe të mirat materiale të dëmtuara që përndryshe nuk paraqesin shpërblim absolut të demit që i është shkaktuar paditësve.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoj se e paditura mbanë përgjegjësi te ndarë në bazë të fajit për demin që i është shkaktuar paditësve me rastin e aksidentit të trafikut për çka e paditura është e obliguar që paditësve t'ia kompensoj demin me që shkaktuesi i demit ka lidhur kontratë me kompaninë e sigurimeve dhe në këto rrethana kompensimin e demit e bënë e paditura mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësisë TPL (Sigurimit të detyrueshëm për palët e treta) konform nenit 136, 137, 140, 159, 169, 174, 177, 178 183 dhe nenit 184 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur ne kuptim te nenit 294 lidhur me nenin 378 të LMD-se.

Vendim për shpenzimet e procedurës është bazuar ne nenin 449 dhe 452.2 lidhur me nenin 453 te Ligjit për Procedurës Kontestimore, lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohen shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuarit të paditësit për 2 seanca të mbajtura në shumë prej nga 1,622.40 euro (meqenëse kemi te bëjmë me përfaqësimin e 5 paditësve ne procedurë dhe

vlera e kontestit te aprovuar është mbi 10.000,00), për hartimin e padis shumë prej 208 euro, për taksën gjyqësore për padi shumë prej 100 euro, apo në shumë të përgjithshme prej 2254.00 euro, duke pasur për bazë se paditësit kanë pasur sukses pjesërisht në këtë proces gjyqësor, andaj gjykata erdh në përfundim se duhet t'ia njoh pjesërisht edhe shpenzimet e procedurës kontestimore, ngase ishin shpenzime të domosdoshme për vërtetimin e drejt dhe të plotë të gjendjes faktike.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 323 lidhur me nenin 143 par.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.480/2015 e datës 23.04.2018

GJYQTARI
Naim Mehulli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.